



## Kërkesë për Certifikatë të Rezidencës Tatimore në Republikën e Kosovës

### *Për personin fizik*

Ju lutem ofroni përgjigjet e plota në mënyrë që ATK-ja të mund të verifikojë gjendjen e biznesit tuaj përndryshe kërkesa juaj mund të refuzohet.

Të dhënat për personin fizik:

1. Emri i personit fizik:

2. Numri fiskal/Numri Personal:

3. Numri Kontaktues dhe e-mail:

4. Adresa e banimit:

5. Arsyeja e kësaj kërkesë:

6. Viti për të cilën kërkohet Certifikata dhe shteti:

7. Shënoni llojin dhe shumën e të ardhurave:

8. Nëse jeni person jo-rezident në Republikën e Kosovës, ju lutem shënoni datën e saktë të arritjes në Kosovë dhe ditët e qëndrimit në Kosovë:

Prej

Deri

Numri i ditëve:

Dokumentet tjera të nevojshme për personin fizik që duhet t'i bashkëngjies kësaj kërkesë, janë:

- Ekstrakti i lindjes;
- Kopja e pasaportës; ose
- Kopja e letërnjoftimit;
- Kontrata

## Udhëzime rreth plotësimit të kërkesës për Certifikatë të Rezidencës nga personi fizik

**Kutia [1]** Shëno emrin dhe mbiemrin e plotë të personit fizik që aplikon për Certifikatë të Rezidencës.

**Kutia [2]** Shëno numrin personal të letërnjoftimit të lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, ndërsa për personin që nuk është rezident në Republikën e Kosovës të shënohet numri i përkohshëm i ID-së i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në Republikën e Kosovës.

**Kutia [3]** Shëno adresën e plotë të banimit p.sh. "Rruga e Barrikadave" Nr.87, Prishtinë.

**Kutia [4]** Shëno numrin kontaktues dhe e - mail ku mund të kontaktohet për kërkesën tuaj për Certifikatë të Rezidencës.

**Kutia [5]** Shëno arsyen pse kërkohet Certifikata e Rezidencës p.sh. për zbatimin e Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

**Kutia [6]** Shëno periudhën dhe vendin për të cilën kërkohet Certifikatën e Rezidencës p.sh. Certifikata e Rezidencës kërkohet për vitin 2017 për Republikën e Shqipërisë.

**Kutia [7]** Shëno llojin dhe shumën e saktë të ardhurave që pranohen nga juridiksioni tjetër jashtë Kosovës gjatë periudhës për të cilën kërkohet Certifikata e Rezidencës p.sh. të ardhurat në pagë në shumën prej 400€ për vitin 2017.

**Kutia [8]** Personi jo-rezident në Republikën e Kosovës shënon datën e saktë të arritjes në Republikën e Kosovës dhe sa ditë qëndron p.sh. hyrja në Republikën e Kosovës me datë 15.03.2017 dhe dalja nga Republika e Kosovës 15.10.2017; qëndrimi në Republikën e Kosovës në total 8 muaj.

Ju lutem dokumentet tjera si ekstrakti i lindjes, kopja e pasaportës, kopja e letërnjoftimit, kontrata që i bashkëngjiten kësaj kërkesë **të jenë valide**.

**Vërejtje!** Kjo kërkesë është për persona fizik të cilëve ju duhet Certifikata e Rezidencës së Kosovës për lehtësim ndërshtetëror nga Marrëveshja për Eliminim të Tatimit të Dyfishtë dhe dëshmi të rezidencës për qëllime tatimore. Kërkesa për Certifikatë të Rezidencës duhet të plotësohet me të dhënat sipas kërkesës dhe t'i bashkëngjiten dokumentet e kërkuara. Certifikata e Rezidencës mund të përdoret vetëm një herë për një kërkesë, në rast se ju duhet tjetër Certifikatë e Rezidencës duhet të aplikoni njëjtë përsëri me të gjitha të dhënat e kërkuara. Certifikata është valide për një (1) vit fiskal.

Ky formular pasi të plotësohet duhet të dorëzohet fizikisht në Arkivën e Administratës Tatimore, Zyra Qendrore, këndi i rrugëve: Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit, ose në adresën elektronike: [metd@atk-ks.org](mailto:metd@atk-ks.org)